

Mundësi të reja për studentë

Në muajin maj, në Prishtinë, do të mbahet gjysmëfinalja e garës "Rasti Sfidues i Kosovës", kur pritet të përzgjidhen nga tre fitues në katër fusha të garës, të cilët pastaj marrin pjesë në finalen, e cila organizohet në Vjenë. Gara është organizuar nga WUS Austria, ndërsa ka për synim studentët e shkëlqyeshëm të Kosovës



Në Kosovë, për pjesëmarrje, do të përzgjidhen studentët e shkëlqyeshëm

Drita Vitia
Prishtinë, 27 janar

Organizata WUS Austria në Kosovë e ka organizuar trajnimin tradicional me temën "Rasti Sfidues i Kosovës", i cili ka për synim studentët dhe kompanitë private në vend. Trajnimi në fjalë përbëhet prej katër fushave, në të cilat studentët mund të garojnë, si në simulimi i gjyqit, gara e rastit të biznesit, modeli i Këshillit Evropian dhe gara e rastit në teknologjinë informative komunikuese. Menaxheri i WUS Austria në Kosovë, But Dedaj, ka thënë se projekti në fjalë është një nga pesë projektet e organizatës WUS Austria, që zbatohen në Universitetin e Prishtinës. "Studentët nga kjo garë përfitojnë dhe ofrojnë diçka që është

lënë anash nëpër institucionet e arsimit të lartë, pra është puna praktike dhe stimulimi i studentëve për punë", është shprehur Dedaj. Sipas tij, këto programe paraqesin një tërësi të programeve që zhvillohen në Universitetin e Prishtinës dhe i testojnë aftësitë e studentëve në praktikë.

Gjysmëfinalja në Prishtinë

Gjysmëfinalja e trajnimit, gara e rastit studimor dhe ngjarje e rekrutimit, pritet të mbahet në Prishtinë, më 7, 8 dhe 9 maj, në të cilën pritet të përzgjidhen dymbëdhjetë studentë, të cilët pastaj do të marrin pjesë në finalen, e cila organizohet në Vjenë të Austrisë. Në gjysmëfinalen, studentët pjesëmarrës pritet të prezantojnë para publikut, i cili do të përbëhet nga juria profesionale dhe përfaqësuesit e kompanive të ndryshme. Me këtë rast, juria pritet

të përzgjedhë në secilën fushë të garës nga tre studentë më të mirë, ndërsa sipas menaxherit

Garat e rastit studimor

Rasti Sfidues i Ballkanit (BCC) është garë e rastit studimor në katër disiplina. Në Kosovë janë përzgjedhur simulimi i gjyqit, gara e rastit të biznesit, modeli i Këshillit të Evropës dhe gara e rastit të teknologjisë informative dhe komunikuese.

But Dedaj, të tjerët përfitojnë pasi kanë mundësi të kyçen në punë, në kompanitë pjesëmarrëse. "Studentët të cilët marrin pjesë kanë mundësi të përzgjidhen nga ndonjë kompani private për punësim, pasi t'i prezantojnë pjesët e tyre", është shprehur Dedaj. Sipas tij, studentët do të prezantojnë

diçka për një rast të caktuar, ndërsa pjesëtarë në juri do të jenë njerëz të kualifikuar në të katër fushat që do të garohet.

Mundësi dhe perspektivë për studentë

Ndërkohë, qëllimi i këtij trajnimi, i cili do të realizohet në formë të garës, është hapja e mundësive dhe perspektivave të reja të studentëve të shkëlqyeshëm të edukimit të lartë në Kosovë, duke i forcuar lidhjet ndërmjet të edukimit të lartë dhe punësimit, si dhe me ofrimin e shanseve konkrete për punë. Gjysmëfinalen e njëmbëdhjetë shteteve pjesëmarrëse mbahen në shtetet përkatëse, për t'u përzgjedhur pastaj për finale nga një numër i caktuar, apo nga tre për secilën fushë. Fituesit e tri vendeve të para do të kenë edhe shpërblime, ndërsa finalja pritet të mbahet prej datës 5 deri më 10 korrik, në Vjenë.